

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 37570/18
Braniella Zerva dhe Stylianos Zervas
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 12 mars 2024, si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,

duke marrë në konsideratë:

kërkesën (nr. 37570/18) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 2 gusht 2018, nga dy shtetas, shqiptar dhe grek, respektivisht znj. Braniella Zerva dhe z. Stylianos Zervas (“kërkuesit”), lindur më 1973 dhe më 1954, respektivisht, banues në Rio, dhe përfaqësuar nga z. K. Tsitselikis dhe A. Spathis, avokatë që e ushtrojnë profesionin në Selanik;

vendimin për të njoftuar në lidhje me ankesat, sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe NENIT 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”), fillimisht përfaqësuar nga agjenti i saj i asaj periudhe z. A. Metani dhe, në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

faktin se Qeveria greke nuk kërkoi të ushtronte të drejtën e saj për të ndërhyrë (neni 36 § 1 i Konventës dhe rregulla 44 § 1 e Rregullores së Gjykatës);

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me drejtësinë e procedurave që çuan në humbjen e pronësisë së kërkuesve ndaj një sipërfaqeje toke. Gjithashtu, ajo ka të bëjë me pajtueshmërinë e procedurave në fjalë me të drejtën e kërkuesve ndaj pronës.

2. Më 30 tetor 2013, kërkuesit depozituan një padi në gjykatë ndaj një përmbaruesi privat, i cili kishte zbatuar vendimin për një borxh dhënë ndaj tyre dhe kishte shitur me forcë një nga pronat e tyre për të paguar një kreditor. Kërkuesit e kundërshtuan vendimin e zbatuar. Gjithashtu, ata pretendonin se përmbaruesi nuk i kishte njoftuar për shitjen e detyruar të pronës së tyre dhe në fund e kishte shitur atë me një çmim më të ulët.

3. Më 9 qershor 2014, Gjykata e Rrethit Korçë e rrëzoi padinë si të vonuar dhe të pambështetur në fakte. Më 20 nëntor 2014, Gjykata e Apelit Korçë e la vendimin në fuqi.

4. Më 21 prill 2017, Gjykata e Lartë e rrëzoi apelimin e paraqitur pranë saj nga kërkuesit, të cilët kishin marrë dijeni për atë vendim më 5 shkurt 2018.

VLERËSIMI I GJYKATËS

5. Sipas nenit 6 § 1 të Konventës, kërkuesit u ankuan se ishte shkelur e drejta e tyre për një seancë të drejtë, pasi autoritetet nuk i kishin njoftuar për procedurat ndaj tyre. Gjithashtu, ata u ankuan se shitja e pronës së tyre shkelte të drejtat e tyre sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

6. Parimet e përgjithshme në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme dhe parimet e subsidiaritetit janë përmbledhur në vendimin *Vučković dhe të Tjerë kundër Serbisë* ((kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69-77, 25 Mars 2014). Duke pasur veçanërisht në konsideratë Shqipërinë, pas ndryshimeve të datës 12 gusht 2016, në lidhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në parim, një ankesë kushtetuese bëhet një mjet efektiv për t'u shteruar për të gjitha ankesat e Konventës (shih *Fullani kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 4586/18, § 79, 20 shtator 2022).

7. Gjykata bie dakord me parashtrimin e Qeverisë, se duke mos depozituar një ankesë kushtetuese, kërkuessit nuk kanë shfrytëzuar mjetet vendëse. Kërkuessit argumentuan se Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ishte kompetente për të gjykuar “vetëm për kushtetueshmërinë e ligjeve”, megjithatë, ashtu siç ishte gjykuar në çështjen *Fullani* (cituar më sipër, § 79), më 12 gusht 2016, një ankesë kushtetuese ishte bërë në parim një mjet efektiv për t'u shteruar për të gjitha ankesat e Konventës.

8. Kërkuessit u vunë në dijeni për vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë më 5 shkurt 2018 dhe, në këto rrethana, u takonte atyre që të depozitonin një ankesë kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese deri më 5 qershor 2018 (shih *Supergrav Albania Shpk kundër Shqipërisë*, nr. 20702/18, § 7, 9 maj 2023). Edhe pse nga data 16 korrik 2018 deri më 14 nëntor 2019, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjykonte apelimet, për shkak të mungesës së kuorumit, gjykata vijonte të regjistronte apelimet që u shqyrtuan, pasi ajo rifitoi kuorumin (shih, për një situatë të ngjashme, *2001 sh.p.k. kundër Shqipërisë* (vendim) [Komiteti], nr. 56080/19, § 12 dhe 6, 30 maj 2023).

9. Kërkuessit nuk depozituan një ankesë kushtetuese dhe për këtë arsye kërkesat e tyre janë të papranueshme për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse, sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 11 prill 2024.

Olga Chernishova
ZËVENDESEKRETARE

Georgios A. Serghides
KRYETAR